



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 682/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani, Kryesuese, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada – Gllogjani anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtarit Ligjorë Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me ankesën e parashtruar nga Vjollca Mjekiqi-Sallova, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal, nga subjekti politik LVV, me seli në Prishtinë, dega në Milloshevë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 10.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e parashtruar nga Vjollca Mjekiqi-Sallova, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Milloshevë, nga radhët e subjektit politik LVV me seli në Prishtinë, dega në Milloshevë, me shenjën ZL.Anr.682/2017, të datës 09.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve(KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunale të mbajtura më datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 09.11.2017 në ora 14:25, nga Vjollca Mjekiqi-Sallova, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal, nga subjekti politik LVV me seli në Prishtinë, me të cilën pretendon se në Milloshevë, në Qendrën e Votimit QV nr. 1502e/01R, 1502E/02R, 1502e/03R, në fshatin Mazgit i Ulët, në Qendrat e Votimit QV nr. 1520e/01R, 15201E/02R dhe në Breznicë, në Qendrën e votimit QV nr1503e/02D, 1503e/01D, PZAP-it i ka kërkuar shqyrtimin dhe rinumërimin e votave .

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë së ankesave dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në ankesën e parashtruar nuk e ka potencuar se sa vota i mungojnë në Milloshevë, në Qendrën e Votimit QV nr. 1502e/01R, 1502E/02R,

1502e/03R, në fshatin Mazgit i Ulët, në Qendrat e Votimit QV nr. 1520e/01R, 15201E/02R dhe në Breznicë, në Qendrën e votimit QV nr1503e/02D, 1503e/01, si dhe në mbështetje të pretendimeve ankimore në ankesë nuk ka ofruar asnjë dëshmi për të vërtetuar krahasimin e votave lidhur me mungesën e votave, sipas pretendimeve ankimore të parashtruara, në kuptim të nenit 117 par. 3 të LZP-së, ku është përcaktuar: “se vendosja për ankesa dhe apele nga PZAP-i mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”. Paneli gjatë vendosjes për një ankesë i shqyrton dhe i heton me kujdes të gjitha provat e bashkangjitura në ankesë dhe kur vlerëson se pretendimet ankimore nuk janë të provuara me prova nga parashtruesi i ankesës, siç është në rastin konkret, ku parashtruesi i ankesës nuk e ka bashkangjitur asnjë provë lidhur me pretendimet e tij, e refuzon ankesën si të pabazuar.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)

Anr.682/2017 më datën 10.11.2017.



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*